



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 20.12.2023, duke filluar në orën 13:00.

Në mbledhje morën pjesë: Pëllumb Bajçinovci, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi dhe Mirsad Vitia.

**Munguan :** Shegë Beqiri, Leutrim Retkoceri dhe Bahri Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Osman Bllaca, Doruntinë Maloku- drejtore e Drejtorisë së Pronës, Mimoza Sylejmani – drejtore e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Izet Sadiku – drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Florim Krasniqi- përfaqësues i Drejtorisë së Urbanizmit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Pëllumb Bajçinovci - kryesues i komitetit, me këtë

### REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme dhe mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë e Financa;
2. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Kongjelit;
3. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Skender (Habit) Krasniqit;
4. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shyhrete (Fazli) Ramës dhe Flamur (Fehmi) Ramës;
5. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Bahtir) Demollit, Albert (Bajram) Mavriqit, Remzush (Bajram) Mavriqit, Hysen (Bajram) Mavriqit dhe Arben (Bajram) Mavriqit;
6. Propozim-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, i dt. 16.6.2010;
7. Propozim-vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm “Kalabria”, 2023-2031, në Prishtinë;
8. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm ” Zona ekonomike “, në Prishtinë;

FaqeInga7



9. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale;
10. Projekt-rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës;
11. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës SHFM “Don Bosko” në Prishtinë;
12. Propozim-vendimi për nismën e bashkëpunimit në mes Kryeqytetit Prishtina dhe Kryeqytetit Kuwait city;
13. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024;
14. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, **Gëzim Sveçla** pyeti se a është me urgjencë pika “**Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës SHFM “Don Bosko” në Prishtinë.**

**Kryesuesi** tha se kjo pikë është urgjente dhe për këtë do jap sqarime.

**Gëzim Sveçla** theksoi se nuk e di sa do të mundemi me shqyrtuar materialin deri nesër. Nëse ka mundësi me tërhequr pikën dhe të mbetet për seancën e radhës.

**Doruntinë Maloku** dha sqarime lidhur me çështjen e kësaj pikë të rendit të ditës që e parashtrou z. Sveçla.

**Nora Kelmendi** pyeti se a do të jepet vetëm parcela në shfrytëzim, pa ndërtesë.

**Doruntinë Maloku** tha se ndërtesat ata i kanë ndërtuar.

**Nora Kelmendi** pyeti se ku është pranimi teknik i ndërtesës, pse ndërtesa nuk është e pasqyruar në certifikatë të pronës, nëse po e jepni në shfrytëzim edhe ndërtesën.

**Doruntinë Maloku** dha sqarime lidhur me pyetjet e parashtruar nga parafolësja.

**Nora Kelmendi** tha nëse këta nuk e kanë legalizuar objektin e na po e japim, duhet shikuar se kjo është shkelje ligjore. Shtyjeni këtë pikë për mbledhjen e ardhshme dhe shikoni a është objekti i legalizuar.

**Kryesuesi** pyeti se a ka mundësi gjatë takimit sa jemi këtu, me marrë informata shtesë për këto çështje.

**Jeta Rafuna** pyeti për mundësinë që kur të sillen propozimet për këmbime të pronave, mos me i sjellë në një seancë 3-4 këmbime. Ajo propozoi që të tërhiqen nga rendi i ditës dy pika të këmbimeve.

**Doruntinë Maloku** u shpreh se nëse ju propozoni me i tërhequr pikat, unë nuk jam kundër.

**Jeta Rafuna** sugjeroi që të mbahen 2 seanca brenda muajit, në mënyrë që me pasur më pak pika dhe me pasur kohë që të përgatitemi për seancë.

**Nora Kelmendi** propozoi që të tërhiqet pika e dytë e rendit të ditës.

**Doruntinë Maloku** propozoi që të tërhiqen pika e tretë dhe e katërt nga rendi i ditës dhe për SHFM “Don Bosko” të shikojmë se çka po marrim informata.

**Nora Kelmendi** bëri të ditur se është hera e dytë që pika e katërt po tërheqim, andaj unë jam kundër tërheqjes së pikës së tretë dhe të katërt nëse nuk e tërheq pikën e dytë sepse e kom arsyetimin tim.

**Osman Bllaca** ishte i pajtimit që të mos hiqet asnjë pikë, sepse disa janë vetëm për diskutim publik, për SHFM “Don Bosko” është pikëpyetje, se neve pastaj po na vijnë pikat tjera për janar.

**Doruntinë Maloku** informoi se nga informatat shtesë nga Drejtoria e Urbanizmit, objekti i SHFM “Don Bosko” ka leje ndërtimi, por nuk e ka lejen e përdorimit, andaj e tërheqim edhe këtë pikë, pra pikën e 11-të prej rendit të ditës.

**Vigan Kastrati** u shpreh se Komuna ende nuk e ka Kod etik, i cili tash e sa vjet na është propozuar edhe prej Ministrisë, ku shumica e komunave të Kosovës ka shumë vite që e kanë. Ne e kemi punuar një draft të propozuar prej Ministrisë, unë e kom dërguar edhe te asamblistët me pa Kodin etik dhe nëse nuk ka ndonjë kërkesë të veçantë, me shtuar apo me hequr, kisha propozuar me e qitur në votim.

**Gëzim Sveçla** pyeti se a e kanë qitur Kodin etik.

**Kryesuesi** tha se e kemi vendosur për ta parë ju, nuk d.m.th. me qenë në këtë seancë vetëm me diskutuar, unë i mora disa vërejtje.

**Gëzim Sveçla** tha se ju mund të bëni Kod etik për të punësuar të komunës e jo për të zgjedhur.



**Vigan Kastrati** theksoi se nuk është i bërë për të zgjedhur, përfshin një pjesë për të zgjedhur, përndryshe Kodi etik - drafti është marrë nga Ministria.

**Kryesuesi** u shpreh se ideja ka qenë që secili prej nesh që jemi këtu, prej grupeve, me e lexuar, me e analizuar.

**Vigan Kastrati** tha se ne e kemi analizuar në të gjitha pikat që është dashur me u diskutuar dhe për këtë është arsye ua kemi dërguar të gjithë asamblistëve që nëse ka vërejtje, sugjerime, do të jenë të mirëseardhura, i presim.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se te neni 5 pika 2 thuhet: “zyrtari politik duhet të respektojë vullnetin e votuesve të partisë deri në fund të mandatit, duke zbatuar programin politik të partisë në emër të së cilës ka marrë edhe mandatin dhe të shmangë ndërrimin e partisë gjatë ushtrimit të mandatit”.

**Vigan Kastrati** tha këta të zgjedhur askush prej nesh nuk mundet me i mohuar, drafti ka ardhur nga Ministria, nuk thotë që nuk guxon me iu shmangur.

**Gëzim Sveçla** theksoi se te neni 7 e kemi shprehjen “ngjyrave të zakonshme”, më tregoni cilat janë ngjyrat e zakonshme.

**Kryesuesi** tha se meqë ka shumë punë, ju sugjeroj të gjitha grupeve që të mbetet për muajin tjetër.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se unë ua kisha propozuar me nda kodin për të zgjedhur, unë pajtohem që Kuvendi komunal duhet pasur Kodin e etikës, por duhet me i nda në mes të të punësuarve dhe të përzgjedhurve, sepse dallohen.

**Vigan Kastrati** theksoi se ne nuk e kemi propozuar me u futur si pikë, e kemi dërguar si draft me lexuar vetëm për diskutim.

**Kryesuesi** tha i rregullojmë edhe këto pjesët që po thoni, drejtoresha Doruntinë propozoi që tërhiqet pika e 11-të. **“Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës SHFM “Don Bosko” në Prishtinë.**

**Gëzim Sveçla** tha se pikat kanë ardhur në rend dite dhe si propozim mundemi me tërhiq ndonjë pikë.

**Kryesuesi** tha se drejtoresha propozoi që të tërhiqen pikat 3 dhe 4. Nëse pajtoheni këto vendosen në seancën e janarit.

**Nora Kelmendi** pyeti drejtoreshën Doruntinë se a ka ndonjë arsyetim që po i tërhiq këto pika, e nuk po i tërhiq pikën e 2-të dhe të 5-të.

**Doruntina Maloku** u përgjigj se nuk ka arsyeshmëri.

**Kryesuesi** tha pika 3. **Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Skender (Habit)Krasniqit;**

**Pika 4. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shyhrete (Fazli) Ramës dhe Flamur (Fehmi) Ramës dhe**

**Pika 11. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës SHFM “Don Bosko” në Prishtinë, me kërkesën e drejtoreshës Doruntinë tërhiqen nga rendi i ditës.**

**Kryesuesi** e paraqiti rendin e ditës me propozimet për tërheqjen e tri pikave të rendit të ditës:

**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Skender (Habit)Krasniqit;**

**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shyhrete (Fazli) Ramës dhe Flamur (Fehmi) Ramës dhe**

**Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës SHFM “Don Bosko” në Prishtinë.**

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua rendi i ri, me ndryshimet e bëra, me tërheqjen e tri pikave nga rendi i ditës.

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme dhe mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë e Financa.**

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme dhe mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë e Financa.

Faqe3nga7



#### **Pika e dytë**

**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Kongjelit.**

Të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Doruntinë Maloku, drejtoreshë**, lidhur me **Propozim-vendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Kongjelit.**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Kongjelit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e tretë**

**Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Bahtir) Demollit, Albert (Bajram) Mavriqit, Remzush (Bajram) Mavriqit, Hysen (Bajram) Mavriqit dhe Arben(Bajram)Mavriqit.**

Të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Doruntina Maloku, drejtoreshë**, lidhur me **Propozim-vendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Bahtir) Demollit, Albert (Bajram) Mavriqit, Remzush (Bajram) Mavriqit, Hysen (Bajram) Mavriqit dhe Arben (Bajram) Mavriqit.**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Bahtir) Demollit, Albert (Bajram) Mavriqit, Remzush (Bajram) Mavriqit, Hysen (Bajram) Mavriqit dhe Arben (Bajram) Mavriqit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e katërt**

**Propozim-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, i dt. 16.6.2010.**

**Izet Sadiku** dha sqarime lidhur me një ndryshim të orarit të kujdestarive të barnatoreve në Kryeqytet. Më 4 shtator e kemi miratuar një orar, që ka filluar të zbatohet më 23 tetor, arsyeja ka qenë se ka qenë një Rregullore e 2010-tës, e cila nuk është zbatuar asnjëherë. Si Drejtori e Shëndetësisë përveç orarit që ka qenë 7-22, e bënë edhe orarin e kujdestarive në Kryeqytet, që realisht nuk ka pasur, dhe e kemi bërë një grup punues edhe prej Odës dhe farmacive që kanë pasur problem dhe ata kanë dhënë një propozim të ri për ta ndryshuar orarin, me e bërë 8:00 – 23:00. Nuk është vetëm rritja e orarit për një orë, por është edhe ndërrim i orarit të fillimit të punës dhe mbarimit të orarit. Po ashtu, grupi punues ka propozuar që 5 ditë të javës me qenë kujdestar, ndërsa uikendet dhe festat me qenë 30 barnatore kujdestare, pastaj ne e kemi propozuar edhe një pikë, që të kemi një mundësi nëse nuk ka barnatore kujdestare mbas orës 23, kryetari me një konkurs të veçantë me e hapur edhe një barnatore të përhershme.

**Gëzim Sveçla** pyeti se a nuk ka interesim prej barnatoreve me bërë kujdestari apo ku qëndron problemi.

**Izet Sadiku** dha sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

**Gëzim Sveçla** pyeti drejtorin se cilat ishin ndryshimet esenciale në mes të kësaj që është e propozuar për nesër dhe asaj që është bërë në shtator, pse po e kufizoni në 30 barnatore, ndoshta dëshirojnë ma shumë.

**Izet Sadiku** bëri të ditur se barnaret e kanë rritur orarin e punës, e kujdestaritë nuk kanë ndryshuar asgjë dhe është rritur numri i kujdestarive për uikend në 30, për këtë ka vendosur grupi punues.

**Gëzim Sveçla** theksoi se ne nesër vijmë në seancë me dy propozime konkrete për Rregulloren për ta përkrahur.



**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim – rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, i dt. 16.6.2010 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e pestë**

**Propozim–vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm “Kalabria”, 2023-2031, në Prishtinë.**

**Mimoza Sylejmani, drejtore,** tha se e kemi një prezantim lidhur me **Propozim–vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm “Kalabria”, 2023-2031, në Prishtinë,** që do ta prezantojmë nesër në Kuvend, por Florimi mund ta propozojë edhe sot në KPF.

**Florim Krasniqi** tha se ky është ndër Planet që është zvarritur më së shumti në Komunë, por tani i ka ardhur momenti për me u diskutuar. Plani si plan i ka tre komponentë në të cilët është bazuar. Komponenti i parë është jetesa, në këtë plan që po tentojmë me krijuar një jetesë me aspektin social në përgjithësi. Komponenti i dytë, për herë të parë pronës komunale i ka dhënë kuptim dhe vlerë përmes këtij Plani. Më këtë Plan po tentojmë me qitë në rend të parë pronën komunale, në mënyrë që me arritur qëllime për interes publik përmes kësaj hapësire. Komponenti i tretë dhe kryesor, është që qytetarët e kësaj pjese me qenë të kënaqur me vlerën e tokës së vetë dhe në të njëjtën kohë edhe realizimin e interesit publik, i cili më herët ka qenë shumë problem me u realizuar me këmbime me shpronësime dhe me këtë plan i është dhënë një qasje tjetër.

**Gëzim Sveçla** kërkoi sqarime lidhur me ndryshimin në mes të Planit të vitit 2021 dhe planit aktual.

**Florim Krasniqi** tha se Plani i 2007-ës nuk ka qenë i miratuar, ndryshime ka, ndryshime në aspektin e infrastrukturës rrugore, si mundeni me pa kjo është njëri prej segmenteve të rrugës “A”. Rrugën “A” e kemi lidhur përmes kësaj rruge, e cila do të ketë qasje të drejtpërdrejtë, po i referohem te pompa “Shell”, te kycja në autostradë.

**Gëzim Sveçla** pyeti se kjo traseja a është ekzistuese, apo planifikohet.

**Florim Krasniqi** tha se kjo është e planifikuar dhe kalon nëpër prona private, të cilave prona u kemi dhënë karakter ndërtues dhe me automatizëm hapet si trase.

**Gëzim Sveçla** pyeti se koeficienti i ndërtimit të pronës që parashihet me qenë park a e ka koeficientin e vetë.

**Florim Krasniqi** bëri të ditur se e ka koeficientin e vetë të garantuar, është menduar që ky pronar që është me e pasur koeficientin 1 e ky tjetri e ka pasur 2.4 dhe nuk kemi bërë ndryshime.

**Gëzim Sveçla** pyeti se me Planin e vjetër ky park çka ka qenë.

**Florim Krasniqi** sqaroi, duke thënë se edhe me planin e vitit 2007 ka qenë park, por çka është përparësia me këtë Plan tani po i jepet e drejtë ndërtimore, atëherë nuk ka pasur fare të drejtë ndërtimore.

**Gëzim Sveçla** pyeti se si shkon kjo pjesa e njoftimit, opinionit, ose banorëve që po bëhet diçka që iu përket atyre.

**Florim Krasniqi** tha se në momentin që miratohet në Kuvend ky vendim për lënien në shqyrtim publik, në momentin që publikohet vendimi në ueb-faqen e Komunës së Prishtinës, ne i marrim masat e nevojshme qoftë nëpër mjet rrjeteve sociale, qoftë me faqe të Komunës, qoftë fizikisht me postera të ndryshëm, i njoftojmë banorët që ky Plan është vënë në diskutim publik, caktohet vendi, lokacioni, ora, caktohet një person i veçantë i cili ka me qenë 15 ditë në dispozicion të qytetarëve për sqarime.

**Gëzim Sveçla** pyeti nëse ka me qenë kërkesë e kësaj pjese të banorëve dinamike e jetës dhe zhvillimit, teknikut është e mundur që këtyre me iu rritur koeficienti me kaluar në ndërtim.

**Florim Krasniqi** u përgjigj në pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

**Gëzim Sveçla** pyeti prej Planit të anuluar në mars të vitit 2022, kufijtë a nuk kanë lëvizur asgjë, po ashtu pyeti se koeficienti 7 a është rritur vetëm në pronë private apo edhe pronë publike.

**Florim Krasniqi** u përgjigj se vetëm pronë publike shtetërore, askund në pronë private.

**Nora Kelmendi** dhe **Gëzim Sveçla** kërkuan disa sqarime lidhur me disa prona se sa e kanë koeficientin, po ashtu për disa prona që janë private e që e kanë koeficientin 7.

**Florim Krasniqi**:- dha sqarime në pyetjet e parashtruara nga parafolësit.

Po ashtu tha edhe nëse është lëshuar ndonjë gabim që në pronën private të jetë koeficienti 7, unë mundem me marrë nesër si vërejtje, vërejtje e cila zotohemi ne si Planifikim që nuk ka me dalë si Plan në diskutim me një koeficient 7 në pronë private, ju paraqitni si çështje unë e marrë për obligim.



**Gëzim Sveçla** tha a e dini se ky Plan e rrezikon sigurinë kombëtare, ky koeficienti 7.

**Florim Krasniqi** dha sqarime lidhur me çështjen që u parashtrua nga Gëzimi.

**Gëzim Sveçla** tha se duhet me shikuar çështjen e pronave. Unë po them publikisht, kam pasur nesër me thënë në seancë se nuk e lejojmë dhe nuk e votojmë, dhe nuk lejojmë me u votuar dhe çfarëdo masa kemi me përdor që dikujt privat me iu rritur koeficienti, prandaj për këtë duhet me pasur shumë kujdes. Ne kemi ardhur me qitë në diskutim publik, me qëllimin që gjatë kësaj faze përmirësohen ato dhe këtyre duhet me ua rritur gjithqysh.

Po ashtu, pyeti pse ka mundësi p.sh. kaq afër është diku është zonë komerciale, diku është zonë e përzier.

**Florim Krasniqi** dha sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar nga Gëzimi.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim–vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm “Kalabria”, 2023-2031, në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e gjashtë**

**Propozim–vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Zona ekonomike“, në Prishtinë.**

Lidhur me **Propozim – vendimin për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Zona ekonomike“ në Prishtinë**, në pika të shkurta informoi Florim Krasniqi.

**Gëzim Sveçla** pyeti seku fillon Zona ekonomike, poshtë ku fillon.

**Florim Krasniqi** tha se fillon prej Ambasadës, prej rrethit të Ismeti, ngjitet përpjetë nga Dragodani, afër KFOR-it bukfalisht zonë ekonomike, se këtu ka zonë për banesa.

**Gëzim Sveçla** e kjo zona për Fushë-Kosovë çka po mbetet ekonomike?

**Florim Krasniqi** tha Zonë industriale.

**Gëzim Sveçla** çka është esenca e kësaj që po rritet?

**Florim Krasniqi** tha se janë dy elemente pse po rritet dhe pse po revidohet ky Plan. Elementi i parë është unaza ekzistuese ka ndryshuar, duhet unaza me u modifikuar për me u inkorporuar propozimi i unazës në këtë Plan, nuk mundemi vetëm me inkorporuar veç ashtu se prek shumë parcela, shumë prona, shumë blloqe i ka gjymtua ajo unazë.

Elementi i dytë është edhe nëse hiq nuk ish rritur kjo vetëm në këtë zonën ku është duke u bërë kampus sporti. Këtu me destinim është zonë ekonomike, këtu është me bërë objekte sportive, d.m.th. nuk kemi rrugëdalje pa i harmonizuar kërkesat me nevojat.

**Gëzim Sveçla** pyeti se tani po e bëjmë sportive apo ekonomike.

**Mirsad Vitia** pyeti lidhur me kalimin e unazës.

**Florim Krasniqi** tha se unaza tash është inkorporuar në Autostradë.

**Gëzim Sveçla** pyeti për arsyen pse ka ndryshuar traseja.

**Florim Krasniqi** dha sqarime lidhur me pyetjen e paraqitur nga parafolesi.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim–vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Zona ekonomike“, në Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e shtatë**

**Propozim–vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.**

**Kryesuesi** tha se këtu kemi të bëjmë me rregulloren e re për ngarkim-shkarkim të sektorit privat në lagje, p.sh. e kemi tani rastin tek Tregu dimëror, kur nuk i përmbahen disa rregulloreve që i kemi bërë, përmes kësaj po mundohemi me mbajtur rregull në situata dhe projekte që nuk kemi qasje.

**Gëzim Sveçla** tha se rregullorja është në rregull, rregullorja e ka edhe aspektin sanksionues.

**Osman Bllaca** bëri të ditur se rregullorja nuk i ka disa nene.

**Gëzim Sveçla** tha atëherë pra duhet me u ndryshuar rregullorja, kjo që quhet kundërvajtje, këtë e cakton ligji, nuk mundet vendimi i komunës me treguar çka është kundërvajtja se është me ligj për kundërvajtje.

**Osman Bllaca** tha se mund ta korrigjojmë këtë.



**Gëzim Sveçla** tha se kjo rregullore nuk mund ta kalojë ligjshmërinë, se jam marrë me te personalisht, se me një faqe tri ligje i shkel edhe për financa, edhe për tarifa dhe rregulloren e Komunës vetë e shkel.

**Nora Kelmendi** tha se pasi nuk është propozuesi këtu pse pe qitni, jemi dakorduar në KPF, nëse nuk është drejtori me propozuar pikën atëherë të tërhiqet.

**Osman Bllaca** tha pikën e shtatë pe tërheqim nga rendi i ditës.

**Kryesuesi** theksoi se me propozimin e anëtarëve po e tërheqim edhe pikën e 7-të: **Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale** nga rendi i ditës.

#### **Pika e tetë**

**Projekt-rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës.**

**Nora Kelmendi** tha se pasi nuk është propozuesi me propozuar pikën, atëherë të tërhiqet edhe kjo pikë, kështu jemi dakorduar në KPF, nëse nuk është drejtori me propozuar pikën, atëherë të tërhiqet.

**Osman Bllaca** tha se pikën e tetë për parkingje mos ta tërheqim, se dy herë ka ardhur dhe ka kaluar, u krye.

**Gëzim Sveçla** tha se në KPF shqyrtohen pikat të cilat kalojnë.

**Osman Bllaca** përsëriti se ne kemi marrë qëndrim që një drejtor që nuk është prezent por e ka pikën, mos me ia miratuar, por **Projekt-rregullore për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës** mos ta tërheqim, se kjo edhe është prezantuar dhe e kemi kaluar dhe nuk ka kurrfarë ndryshimi.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrash **Projekt-rregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e nëntë**

**Propozim-vendimi për nismën e bashkëpunimit në mes Kryeqytetit Prishtina dhe Kryeqytetit Kuwait city.**

**Kryesuesi** tha se ky është një propozim i qeverisjes së kaluar, Ministria e ka kthyer te ne me zyrtarizuar, kjo është më e hershme.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrash **Propozim-vendimi për nismën e bashkëpunimit në mes Kryeqytetit Prishtina dhe Kryeqytetit Kuwait city dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e dhjetë**

**Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024.**

**Nora Kelmendi** pyeti se a e keni sjellë raportin për realizimin e Planit, se ashtu jemi pajtuar vjet, që keni thënë se keni me sjellë raportin, sillni raportin siç është realizuar.

**Gëzim Sveçla** tha benë nesër, raportin silleni e dërgojmë edhe përfaqësuesin në grup.

**Nora Kelmendi** tha nëse e bëni raportin, atëherë e keni edhe formimin e grupit punues, se sivjet nuk e kemi pasur.

**Kryesuesi** tha unë mendova me bërë dhe me qenë pjesëmarrës, se kjo po duket gjysmake, kisha propozuar me bërë një risi, ai komision në pikat dhe rregulloren mundemi me bërë.

**Osman Bllaca** tha në janar e bëjmë rregulloren.

**Jeta Rafuna** tha se KPF-ja duhet me bërë Rregulloren.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrash **Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

*Mbledhja përfundoi në orën 15:00.*

**Procesmbajtësja**  
**Shyhrete Islami**

Faqe 7 nga 7

